

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.L. nga fsh. Hogosht, K. Kamenicë, për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit R.L., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.265/2014 datë 08.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 24.10.2017 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit R.L., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.265/2014 datë 08.03.2017, **vërtetohet.**

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin PKR.nr.265/2014 datë 08.03.2016, e ka shpallur fajtor të akuzuarin R.L., për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, për çka e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditë, të cilin dënim detyrohet që ta filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK të akuzuarit në fjalë do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar periudha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt. 24.09.2014 gjer me dt.19.11.2014. Detyrohet i akuzuari që të paguaj në emër të paushallit gjyqësore shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë të përbashkët kanë paraqitur:

- Mbrojtësit e të akuzuarit R.L. av. S.R. dhe av. Sh.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së Kodit Penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet, konform nenit 364 par.1 i akuzuari të lirohet nga akuza ose aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën ta kthej në vendosje të serishme.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë nuk prezantuan Prokurori i Apelit dhe av. S.R. edhe pse të ftuar me rregull, ndërsa prezent ishin i akuzuari R.L. dhe mbrojtësi i tij av. Sh.P.j. Mbrojtësi mbeti pranë pretendimeve ankimore me shkrim, i akuzuari R.L. përkrahi fjalët e mbrojtësve të tij.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.433/2017 të dt. 29.09.2017 ka propozuar që ankesa e mbrojtësve të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-ankesa nuk është e bazuar.**

Mbrojtësi në ankesën e tij thekson se aktgjykimi në vete përmban shkelje esenciale të dispozitave të nenit 384 par.1 pika 1.12 të KPRK, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit të goditur është i pakuptueshëm kundërthënës me vetveten, në dispozitivin e aktgjykimit nuk janë potencuar shkaqet lidhur me faktet vendimtare apo shkaqet e potencuara janë të pakuptueshme dhe në masë të madhe kundërthënëse. Dispozitivi është i pakuptueshëm sepse nuk është bërë përshkrimi i drejtë i cilësimit juridik dhe nuk është theksuar se për çfarë formë të fajit në rastin konkret bëhet fjalë, në dëm të akuzuarit R.L. është bërë edhe shkelja e Kodit Penal e të cilat shkelje janë të natyrës absolute për të cilat gjykata është e obliguar që të kujdeset sipas detyrës zyrtare, vepra penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së është veprë penale vetëm atëherë kur për vete apo tjetrin i sjell ndonjë dobi përfitim, shkaktohet ndonjë dëm ndonjë personi tjetër, ose që seriozisht i shkelet e drejta personit tjetër. Për ekzistimin e veprës penale është e domosdoshme që fitimi për vete apo tjetrin është realizuar gjegjësisht që tjetrit ti jetë shkaktuar dëmi. Në rastin konkret nuk janë sajuar tiparet e kësaj vepre penale e kjo ka të bëjë me atë se kjo veprë penale kryhet me dashje të drejtpërdrejte e me qëllim në anën e të akuzuarit nuk është vërtetuar ky element subjektiv atëherë veprimet e të akuzuarit mund të kenë karakter të përgjegjësive disiplinore e jo asaj penale. Në rastin konkret as nuk është vërtetuar se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë, i njëjti në të gjitha veprimet e ndërmarra në procedurat e proceduara është bazuar ekskluzivisht në aktet ekzekutive normative kur ka marrë vendimet e cekura, ku në mënyrë decisive ka përcaktuar edhe kornizën për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara ligjore për subjektet e involvuara në procedurat e zbatuara, pra nga materiali i tubuar në shkresat e lëndës të mbrojturit tim assesi nuk rezulton se klienti im mban ndonjë përgjegjësi penale për veprën penale për të cilën padrejtësisht i përshkruhet të njëjtit dhe për të cilën është shpallur fajtorë. Faktet me të cilat duhet bazohet aktgjykimi duhet të jenë fakte vendimtare dhe si të tilla të domosdoshme të vërtetuara në mënyrë të padyshimte dhe të sigurt. Meqenëse ky aktgjykim e ka sjellë në pozitë të palakmueshme të akuzuarin R. , ne konsiderojmë se provat të cilat janë shtjelluar asnjëra prej tyre veç e veç dhe si tërësi nuk e argumentojnë përgjegjësinë penale të mbrojturit tim. Kjo na bënë që të nxjerrim konkludimin e vetëm se i akuzuari në fjalë nuk e ka keqpërdorur e as të ketë tejkaluar kompetencat e tij. Me rastin e lartësisë së dënimit gjykata e shkallës së parë ka pas parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat janë potencuar në aktgjykimin e goditur. Në rastin konkret konsideroj se nuk duhet ti elaborojmë as rrethanat lehtësuese as rënduese sepse për çështjen penale ku është shpallur fajtor i mbrojturi im, versioni si mbrojtës është krejt tjetër.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit R.L. si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të

dispozitive të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palës mbrojtëse si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit. Kjo gjykatë vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. Nga administrimi i provave personale dhe atë nga dëshmia e dëshmitarit N.H.-komandant i Stacionit policor në Kamenicë, dëshmitarit R.V., R.S., A.S., Sh.Th., pastaj provat materiale vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02.11.2011 për ndalimin e eksploatimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në tërë territorin e Republikës së Kosovës për tri vite nga data e hyrjes në fuqi pra me 02.11.2011 e ku operatorët që operojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të ju konfiskohet makineria dhe materiali kurse ndaj personave juridik dhe fizik të iniciohet procedurë gjyqësore si dhe provat materiale të theksuara në faqen 10 dhe 11 të aktgjykimit të shkallës së parë, ka rezultuar se operatorët derisa kanë transportuar rërë dhe zhavorr janë ndaluar nga policia për shkak të mungesës të dokumentacionit valid, i akuzuari në shumicën e rasteve duke tejkaluar kompetencat e tij zyrtare ka lëshuar që këto mjete transportuese të lirohen që të shkojnë të ngarkuar në destinacion gjegjësisht operatorëve të cekur në dispozitiv të aktgjykimit. Nga dëshmitari N.H. është vërtetuar se rëra e pa përpunuar e cila kinse është dërgua në fshatin Laqiq e ku është seperuar dhe është destinuar për treg dhe se kjo rërë kinse ka qenë e importuar nga Serbia. Nga lista e distribuimit nr.05-3/605 të dt. 08.10.2011 lëshuar nga doganat e Kosovës lidhur me importimin e rërës dhe zhavorrit për periudhën kohore janar 2013 deri me 24.11.2014 kompanitë Sh.P.K. “NN2”, Sh.p.k. “NN3” dhe Sh.p.k. “NN1 ” nuk kanë importuar kurrfarë materiali inert- rërë apo zhavorr e as kompanitë tjera përfaqësues e të cilëve janë dëgjuar si dëshmitar si Sh.Th. ku vllau i tij I.Th. është pronar i Sh.p.k. “NNi” Nga dëshmitari N. vërtetohet se i njëjti ka dalur në teren dhe ka vërejtur gjendjen katastrofale për shkak të eksploatimit të pa kompletuar të rërës dhe zhavorrit duke mos u mbushur me material tjetër edhe pse kjo është obligim ligjor. I njëjti ka njoftuar instancat tjera policore në Gjilan sipas shkresës me datë 04.04.2014 e sidomos për kompaninë “NN1 ” të cilin personalisht e ka hasur duke eksploatuar rërë në kundërshtim me vendimin e qeverisë. Po ashtu ka theksuar se inspektorët komunal të Kamenicës edhe pse i kanë hasur pa dokument valid për transportim të rërës kompanitë të njëjtit i kanë lëshuar. Po ashtu nga transkriptet e bisedave telefonike në mes të akuzuarit dhe operatorëve është vërtetuar se i akuzuari R. ka kaluar autorizimet e tij si inspektor komunal duke i liruar transportierët e këtyre operatorëve edhe pse pa dokument valid duke i udhëzuar përmes telefonit se si ta sigurojnë dokumentacionin qoftë edhe fiktiv. Po ashtu nga dëshmitarët R.V. dhe Sh.Th. të cilët pas ballafaqimit nga transkriptet nga bisedat telefonike e pranojnë bisedën me të akuzuarin R. edhe pse në mënyrë të modifikuar porse nga përmbajtja e kësaj bisede vërtetohet veprimi inkriminues i të akuzuarit i cili duke tejkaluar kompetencat e tij ju ka ndihmuar në forma të ndryshme kompanive që merren me eksploatimin e rërës dhe zhavorrit e sidomos atyre kompanive të cekura në dispozitiv të aktgjykimit. Kjo gjykatë vlerësoi pretendimin ankimor të mbrojtjes si të pa bazuar kur i njëjti thekson se veprimet e të mbrojturit të tij nuk mund të merren si veprime inkriminuese penale por më së shumti përgjegjësi disiplinore pasi që ka munguar dashja e drejtëpërdrejtë, se mungon përfitimi material ose jo material, shkaktimi i dëmit personit. Nëse

analizohet dispozita e nenit 422 par.1 i KPRK pretendimet e mbrojtjes janë të pa bazuara pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar ka tejkaluar kompetencat e tij, pavarësisht se nuk është provuar se ka pasur dobi për vete mirëpo është evidente se operatorët ekonomik duke eksploatuar rërën dhe zhavorrin në kundërshtim me vendimin e qeverisë të cekur më lartë përmes këtij tejkalimi kompetencash u ka mundësuar atyre përfitim apo dobi si dhe dëmi i shkaktuar nga eksploatimi i materialeve inerte, rërës dhe zhavorrit. Veprimet e të akuzuarit në drejtim të ndihmës për operatorët ekonomik që të këshillohen për sigurimin e dokumentacionit fiktiv nga Serbia assesi nuk e futin veprimin e të akuzuarit në sferën e përgjegjësisë disiplinore por pikërisht i njëjti si person zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i ka tejkaluar kompetencat e veta që tu mundësoj dobi personave të tjerë në rastin konkret operatorëve ekonomik të theksuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit av.S.R. dhe av. Sh.P., nuk janë të bazuara pasi që mbrojtësit edhe pse e kanë theksuar bazën ankimore të vendimit mbi dënim të njëjtën nuk e kanë elaboruar por janë thirrur në atë se nuk duhet elaboruar as rrethanat lehtësuese e as ato rënduese pasi versioni i mbrojtjes është krejt tjetër. Mirëpo, Gjykata e Apelit sipas detyrës zyrtare vlerësoi aktgjykimin edhe përkitazi me vendimin mbi dënim ashtu që duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë, si më parë i pa dënuar, mbajtës i familjes përfshirë bashkëshorten dhe fëmijët si dhe sjelljen korrekte të tij, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
PAKR.nr.457/2017, më 24.10.2017

Procesmbajtëse,  
Leonita Lajqi

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja  
1. Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Have Haliti \_\_\_\_\_